

K O N T R A T E

MBI KRIJIMIN E SHOQERISE

" DV - ALBTURIST HOTELIERS " SH.P.K.

ndermjet

ALBTURIST, ndermarrje shtetore e te drejtes shqiptare me qender ne Tirane, Bulevardi " Deshmoret e Kombit " n. 8, e perfaqesuar nga Drejtori i saj i Pergjithshem, Z. Valentin Prifti ( qe me poshte eshte quajtur Albturist )

dhe

DI VINCENZO ESTERO Srl, shoqeri e te drejtes italiane me qender ne Rome, Via Enrico Monaci nr. 21, e perfaqesuar nga Administratori i deleguar, Z. Antonio Napoleone ( e quajtur me poshte DVE ), te dyja te quajtura me poshte "Pale".

Ne baze te Ligjeve te Kuvendit Popullor te Republikes se Shqiperise N.7496 date 04.08.1992 " Mbi investimet e huaja "dhe N.7638 date 19.11.1992 "Mbi Shoqerite Tregetare ", Palet kane rene dakord sa vijon:

NENI 1

Palet bien dakord per te krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, per te kryer bashkarisht aktivitetin ekonomik, industrial dhe tregetar te pershkruar ne Nenin 3 ( me poshte quhet " Shoqeri " ) me emertimin :

" DV ALBTURIST HOTELIERS" SH.P.K.

dhe emertimin e shkurtuar

"DV - ALBA SH.P.K."


Shoqeria e ka qendren ne Republiken e Shqiperise ne Tirane, prane Hotel Tiranes, sheshi Skenderbej dhe do te ushtroje aktivitetin e saj per nje periudhe 50 vjecare, e rinovueshme kjo nga nje mareveshje me shkrim e Paleve.

NENI 2

Shoqeria eshte nje person juridik sipas te drejtes shqiptare,veprimtaria e se ciles rregullohet nga kjo kontrate, statuti i saj bashkelidhur dhe legjislacioni shqiptar.

Shoqeria pergjigjet vetem me pasurine e saj dhe ne asnje rast nuk pergjigjet per detyrimet e marra persiper prej ortakeve, dhe keta te fundit nuk pergjigjen per detyrimet e Shoqerise dhe nuk perballojne humbjet e saj pertej kuotes se kapitalit qe ata kane derdhur.

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e shtetit shqiptar dhe anasjelltas.



### NENI 3 OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte ristrukturimi i Hotel Tiranes (qe me poshte do te quhet "Hoteli") duke e kthyer ne nje Hotel me tre yje sipas standarteve bashkekohore nderkombetare dhe administrimi i tij me anen e nje shoqerie menaxhimi me prestigj te njohur nderkombetare; objekti parashikon gjithashtu ushtrimin ne Shqiperi drejtperdrejt apo terthorazi te industrise se turizmit, nepermjet realizimit, ristrukturimit dhe administrimit te komplekseve turistike. Shoqeria mund te zhvilloje dhe veprimtari qe kane lidhje me realizimin e arritjeve e qellimeve te Shoqerise te siperpermendura.

Gjithashtu Shoqeria mundet, brenda kufijve te parashikuara nga legjislacioni shqiptar, ne menyre jo mbizoteruese dhe me qellimin e vetem te arritjes se objektit te Shoqerise te siperpermendur, duke perjashtuar cdo qellim spekulativ, te marre pjese ne fitimet dhe te beje pjese ne Shoqeri te tjera te se drejtes shqiptare, te krijuara dhe/ose qe do te krijohen qe te kene qellime te njejta ose te lidhura me te, si edhe te krijojne joint-ventures me partnere shqiptare dhe/ose te huaj.

Se fundi, Shoqeria mund te kryeje, gjithmone ne menyre jo mbizoteruese, drejtperdrejt ose terthorazi, veprime per pasuri te palujtshme, te lujtshme, industriale, tregtare, transporti, import-eksporti qe lidhen me qellimin e Shoqerise ose qe mund te lehtesojne arritjen e tij.

### NENI 4 KAPITALI THEMELTAR DHE PJESEMARRJA

Kapitali themeltar ne momentin e krijimit te Shoqerise eshte 100.000 (njqind mije)USD dhe do te derdhet nga ortaket ne para. Ortaket marrin pjese ne kapitalin themeltar te Shoqerise, si me poshte:

Albturist	49.900 USD
DVE	50.100 USD

Palet duhet te parashikojne nje zmadhim te kapitalit themeltar te Shoqerise para se te filloje ristrukturimi i Hotelit, si vijon:

a) Albturisti do te nenshkruaj kontributin e vet ne natyre duke i kaluar Shoqerise pronesine e nderteses se Hotelit me anekset perkatese, paisjet dhe aksesoret, te lire nga cdo hipoteke, privilegj ose barre te cdo lloji, me vlere prej 5.000.000( pese milion ) USD.

Palet bien dakort qe aktivi dhe pasivi qe rrjedh nga administrimi i hotelit deri ne momentin e fillimit te punimeve te ristrukturimit te tij , mbeten ne ngarkim te Albturistit . Albturisti garanton Shoqerine gjithashtu nga cdo pretendim ose rivendikim nga te tretet per truallin mbi te cilin eshte ngritur ndertesa e hotelit .

Shoqeria do te vere ne dispozicion te Albturistit ne momentin e kalimit tek ajo te pronesise te nderteses te hotelit , nje siperfaqe me rreth 400 m ne katin e pare e specifikuar ne skemen bashkelidhur ,kesaj kontrate , per ta perdorur Albturistin per nevojat e tij per nje periudhe 25 ( njezetepese ) vjet me nje qira vjetore simbolike .Te

gjitha keto do te permbahen ne nje marreveshje te vecante me shkrim , ndermjet Shoqerise dhe albturistit , qe do te jete pjese perberese e kesaj kontrate.

b) DVE-ja do te nenshkruaj kontributin e vet ne para ne shumen prej 4.970.000 ( kater milion e nenteqind e shtatedhjet mije ) USD. Bashke me zmadhimin e kapitalit si mesiper, DVE-ja do te bleje nga Albturist nje kuote te kapitalit te Shoqerise baraz me 49.900 (dyzet e nentemije e nenteqind ) USD me vlere nominale.

Cdo veprim lidhur me kapitalin e Shoqerise do te behet ne USD.

Derdhjet do te behen ne nje sportel te nje Banke te autorizuar te Shtetit Shqiptar ku do te hapet nje llogari bankare ne USD ne emer dhe per llogari te Shoqerise.

Ne librin e llogarive te Shoqerise do te regjistrohet kapitali themeltar ku do te specifikohet kontributi i derdhur dhe/ose i dhene nga secila pale.

Albturist i nje DVE-se, perjashtimisht nga dispozita e nenit 9 te Statutit, te drejten t'u kaloje lirisht ne cdo moment por vetem nje here gjate periudhes te kohezgjatjes se Shoqerise, te tere ose pjese te kontributit te saj ne Shoqeri , njeres ose me shume shoqerive te grupit Di Vincenzo ( te quajtur ndryshe grupi NORMA ).

Albturist i nje DVE-se perjashtimisht nga dispozitat e nenit 9 te Statutit, te drejten qe ajo t'u kaloje lirisht te treteve nje pjesemarrje jo me te larte se 60% te kuotes se vet ( duke perfshire ne kete perqindje edhe kuotat qe u perkasin shoqerive te tjera te grupit Di Vincenzo ( qe quhet edhe grupi NORMA ) ku D.V.E ka ceduar me pare pjese te pjesemarrjes se saj sipas paragrafit te mesiper ) brenda dhe jo me vone se data e rihapjes se Hotelit pas ristrukturimit .

#### NENI 5

Shoqeria do te filloje aktivitetin e saj pas regjistrimit ne Gjykatën e Tiranës te Shkalles se Pare si dhe ne Ministrine e Ekonomise dhe Financave te Republikës se Shqipërisë.

#### NENI 6

Fitimet neto te realizuara nga Shoqeria mbas zbritjes te shumave per taksat, tatimet dhe shpenzimet e tjera ne perputhje me legjislacionin shqiptar, do tu ndahen Ortakeve ne menyre proporcionale me pjesemarrjen e tyre respektive ne kapitalin themeltar.

Fitimi qe do tu ndahet ortakeve te huaj mund te transferohet jashte shtetit, ne perputhje me Ligjin nr.7496 date 4.08.1992 "Per investimet e huaja".

#### NENI 7

Veprimtaria ekonomike e Shoqerise dhe investimet e ortakeve te huaj ne kete veprimtari mbrohen nga shteti shqiptar, i cili u garanton atyre kushte te barabarta me ato qe parashikohen per personat juridike shqiptare.

#### NENI 8

#### DETYRIMET E ORETAKEVE

DVE detyrohet:

- te pergatise projektin e te gjithe dokumentacionit per krijimin e Shoqerise, ndermjet te cilave kontraten dhe statutin;

  
DI VINCENZO ESTERO s.r.l.  
L'AMMINISTRATORE DELEGATO



- b) te ndihmoje Shoqerine ne veprimtarite drejtuese dhe organizative;
- c) te pergatise, ne bashkepunim me Ortaket e tjere dhe me shoqerine menaxhuese, studimin final te fatibilitetit tekniko -ekonomik;
- d) te ndihmoje Shoqerine ne bisedimet me institucionet financiare me qellim qe te merren financimet e nevojshme per ristrukturimin e hotelit;
- e) te ndihmoje Shoqerine ne bisedimet me shoqerine menaxhuese me qellim qe te sigurohen kushte me te mira per kontraten e menaxhimit.

ALBTURISTI detyrohet :

- (a) ti siguroje Shoqerise seline duke i vene ne dispozicion nje apartament prane Hotelit me sherbimet perkatese si telefon, fax.
- (b) te ndihmoje Shoqerine per lidhjen dhe/ose zgjerimin e sherbimeve te perdorimit si ( telefon, uje, drite, etj. ), sipas nevojave teknike te Hoteli si dhe gjetjen e materialeve dhe atrecaturave te ndryshme, qe gjenden ne vend, per ristrukturimin e Hotelit nga ana e Shoqerise.
- (c) te bashkepusoje me DVE dhe shoqerine menaxhuese me qellim qe te pergatise studimin e fatibilitetit tekniko ekonomik
- (d) te ndihmoje Shoqerine per te marre nga autoritetet kompetente shqiptare te gjitha autorizimet, miratimet, lejet etj. te cfardo natyre qofshin , te cilat do te jene nevojshme per kryerjen e punimeve te ristrukturimit te Hotelit dhe per menaxhimin e metejshem te tij.

#### Neni 9


Palet marrin persiper te bejne c'eshte e mundur me qellim qe ndermarrja qe do te beje punimet e ristrukturimit te hotelit dhe ajo qe do te administroje hotelin te perdore me perparesi personelin qe eshte i punesuar sot ne Hotel, por duke patur gjithnje parasysh kriterin e efikasitetit, te kualifikimit dhe te leverdise ekonomike. Palet marrin persiper gjithashtu qe shoqeria te mbaje ne pune me pagat e zakonshme gjithe personelin e punesuar qe aktualisht ushtron veprimtarine e vet punonjese prane hotelit , deri ne perfundimin e punimeve te ristrukturimit te tij , nqs ata nuk do te punesohen ndryshe.

#### NENI 10 ORGANET E SHOQERISE

Organet e Shoqerise jane :

- (a) Asamblea e Ortakeve
- (b) Keshilli Administrativ
- (c) Presidenti
- (d) Drejtori i Pergjithshem
- (e) Zv.Drejtori i Pergjithshem
- (f) Komisioni i Revizionit

Mondalitet e perberjes dhe funksionet e tyre percaktohen ne menyre te detajuar ne Statutin e Shoqerise, qe bashkelidhet dhe eshte pjese perberese e kesaj kontrate.

  
DI VINCENZO ESTERO  
L'AMMINISTRAZIONE DELEGATA

Brenda tre javesh nga rregjistrimi i Shoqerise prane Ministrise se Ekonomise dhe Financave te Republikes se Shqiperise, do te thirret Asamblea e Ortakeve ne Seline e Shoqerise per te percaktuar personat dhe detyrat e sejcilit. Megjithate eshte rene dakort qe Keshilli Administrativ te perbehet nga 7 keshilltare te cilet do te caktohen perkatesisht nga Albturist ( 3 anetare) dhe nga DVE ( 4 anetare).

Presidenti dhe Zv/drejtori i pergjithshem do te zgjidhen ndermjet anetareve te keshillit Administrativ te emeruar nga ALBTURISTI. Drejtori i Pergjithshem do te zgjidhet ndermjet anetareve te Keshillit Administrativ te emeruar nga D.V.E.

#### NENI 11

Palet marin persiper reciprokisht te ruajne karakterin konfidencial te dokumentacionit, te informatave, te te dhenave si edhe te perveses se fituar gjate veprimtarise te Shoqerise dhe te marrin masat e nevojeshme per te penguar perhapjen e tyre qofte edhe pjeserisht.

Palet pergjigjen per demet qe mund te pesoje Shoqeria nga mosrespektimi i detyrimeve te mesiperme.

#### NENI 12

Kjo kontrate eshte e vlefshme per 50 vjet. Palet kane te drejte te shtyjne afatin ose te vendosin mbarimin e parakohshem te shoqerise sic parashikohet ne nenin 4 te Statutit .

#### NENI 13

Ne rast mosmarveshjesh lidhur me interpretimin, zbatimin dhe zgjidhjen e kesaj kontrate, kur keto mosmarveshje nuk do te zgjidhen ne menyre miqesore ato do te paraqiten per zgjidhje ne nje Gjykate Arbitrazhi te perbere nga tre arbitra, te caktuar sipas normave te Rregullores te Gjykates se Arbitrazhit te Dhomes se Tregetise Nderkombetare Paris. Vendi i gjykimit do te jete Parisi dhe gjuha e gjykimit, frengjishtja.

Procedura e arbitrazhit do te zhvillohet sipas Rregullave te Dhomes se Tregetise Nderkombetare te Parisit. Kolegji i arbitrazhit do te kete funksione miqesore, do te gjykoje me drejtesi dhe duke garantuar kontraditoritetin.

Vendimi i arbitrazhit do te jete i paapelueshem dhe i detyrueshem per palet.

#### NENI 14

Shoqeria do te rregullohet nga nenet e kesaj kontrate dhe nga Statuti qe jane konform dispozitave te ligjit, dhe per cka nuk eshte parashikuar nekete Kontrate dhe ne Statut, nga ligjet dhe dispozitat e tjera shqiptare. Nese ligjet apo dispozitat shqiptare ne te ardhmen do te ndryshohen ne menyre me te favoreshme per Shoqerine dhe/ose palet,

keta te fundit marrin persiper qe tani rrjedhimisht te ndryshojne kete kontrate dhe statutin .

#### NENI 15

Kjo kontrate eshte hartuar ne gjuhen shqipe dhe italiane qe kane vlere te barabarte.

Gjate mbledhjeve te te Asamblese, te Keshillit Administrativ dhe te Komisionit te Revizionit, gjuha zyrtare do te jete shqipja. Per pjesemarresit ne mbledhje qe nuk e njohin kete gjuhe, me shpenzimet e shoqerise do tu sigurohet sherbimi i perkthimit simultan.

Te gjitha dokumentacionet zyrtare te Shoqerise, proces verbalet, relacionet, bilancet etj. duhet te parapergatiten njekoheisht pervec gjuhes zyrtare shqip edhe ne gjuhen italiane. Kjo detyre i takon Shoqerise.

Korrespondenca midis paleve e midis Shoqerise dhe paleve lidhur me kontraten si dhe dokumentacioni teknik i projektit te Hotelit duhet te behen ne gjuhen italiane

#### NENI 16

Kjo kontrate do te konsiderohet e zgjidhur pa asnje pasoje per palet, ne rast se deri me 28.02.1994 nuk do te merren financimet e nevojshme per ristrukturimin e Hotelit, dhe nuk do te fillojne punimet e ristrukturimit , pervec kur palet merren vesh me shkrim per shtytjen e ketij afati.


Kjo kontrate u hartua ne dy origjinale ne gjuhen shqipe dhe italiane . Cdo ortak do te marre nga nje original ne secilen gjuhe .

Kjo kontrate u lexua, u miratua dhe u nenshkrua ne Tirane me 6 maj 1993, dhe eshte e detyrueshme qe tani per palet, por do hyje ne fuqi ditën e marrjes se autorizimit nga organi kompetent i caktuar me Ligjin nr.96 date 4.08 1992 "Per investimet e huaja".

Per Ortaket :

ALBTURISTI

Z. Valentin Prifti



DVE

Z. Antonio Napoleone



DI VINCENZO ESTERO sri  
L'AMMINISTRATORE DELEGATO



# STATUT

i shoqerise

" DV- ALBTURIST HOTELIERS Sh.p.k. "

" DV-ALBTURIST Sh.p.k " ( qe me poshte quhet shoqeria ) eshte themeluar ne baze te kontrates ( " Kontrata" ) lidhur me 6 maj 1993 , midis ALBTURIST, ndermarrje shtetere e se drejtes shqiptare me seli ne Tirane ( Shqiperi ) , Bulevardi " Deshmoret e Kombit" n.8 , dhe DI VINCENZO ESTERO S. r.l. shoqeri e se drejtes italiane , me seli ne Rome , Via Enrico Monaci n .21 dhe ne perputhje me Ligjet e Kuvendit Popullor te Republikes se Shqiperise Nr. 7496 dt 04.08.1992 " Mbi investimet e huaja " dhe nr.7638 dt 19.11.1992 " Mbi Shoqerite tregetare " per te zhvilluar veprimtari ekonomike te perbashket , sic parashikohet nga Kontrata dhe nga ky Statut.

## K R E U I

### DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1


Emertimi

Shoqeria emertohet " DV-ALBTURIST HOTELIERS Sh.p.k " , ne forme te shkurtuar : " DV-ALBA Sh.p.k."

Shoqeria eshte nje person juridik i se drejtes shqiptare .

Shoqeria gezon te drejten e personit juridik shqiptar nga data e leshimit te autorizimit perkates prej organit kompetent shqiptar .

Shoqeria zhvillon veprimtarine e vet ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e Kontrates dhe te ketij Statuti.



  
DI VINCENZO ESTERO S.R.L.  
L'AMMINISTRATORE DELEGATO

12

## Neni 2

### Objekti i shoqerise

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte ristrukturimi dhe administrimi i " Hotel Tirana " sipas nenit 3 te kontrates ( qe me poshte emerohet " Hoteli") si edhe ushtrimi ne Shqiperi , drejteperdrejt ose indirekt , i industrise se turizmit , nepermjet realizimit ,ristrukturimit dhe administrimit te komplekseve turistike . Shoqeria mund te zhvilloje edhe veprimtari qe kane lidhje me realizimin e arritjen e qellimeve te Shoqerise qe permenden me siper . Shoqeria brenda caqeve te parashikuara nga legjislacioni shqiptar , ne menyre jo mbizoteruese , dhe me qellim qe te realizohet objekti i mesiper m i Shoqerise ,duke perjashtuar cdo qellim spekullimi , mund te marre pjese ne fitime e ne shoqeri te tjera te themeluara dhe/ose ne themelim e siper te se drejtes shqiptare,qe ndjekin qellime analoge ose qe kane lidhje me objektin e saj,si edhe te lidhe kontrata per ndermarrje te perbashketa me partnere shqiptare dhe/ose te huaj.

Shoqeria,se fundi,mund te kryeje,gjithnje ne menyre jo mbizoteruese,drejteperdrejt ose indirekt,veprime qe kane lidhje me pasuri te palujtshme,te lujtshme,industriale,tregtare, me transportet,me import-eksportin e qe kane te bejne me qellimin e shoqerise ose qe mund te lehtesojne realizimin e ketij qellimi.

## Neni 3

### Selia e Shoqerise-Vendbanimi i ortakeve

Shoqeria e ka seline e saj zyrtare ne Tirane (Shqiperi),ne Hotel Tirana,Sheshi Skenderbej.

Shoqeria,me vendim te organeve te saj kompetente,rast pas rasti,mund te krijojte,te transferoje dhe/ose te anulloje seli sekondare,seli administrative,drejtori,filiale,dege,agjensi dhe zyra si ne territorin shqiptar ashtu dhe jashte shtetit.

Vendbanimi i ortakeve,per sa u takon marrredhenieve te tyre me Shoqerine eshte ai qe shenohet ne Librin e Ortakeve.

## Neni 4

### Kohezgjatja e Shoqerise

Kohezgjatja e Shoqerise eshte caktuar deri me 31 dhjetor 2043.

Asamblea eOrtakeve me propozimin e secilit ortak , mund te vendose zgjatjen e afatit ose shperndarjen para afatit te Shoqerise.

  
DI VINCENZO ESTERO s.r.l.  
L'AMMINISTRATORE DELEGATO



## Neni 5.

### Pergjegjesia e Shoqerise

Shoqeria pergjigjet vetem me pasurine e saj dhe ne asnje rast ajo nuk pergjigjet per detyrimet e marra persiper nga ortakët e as keta te fundit nuk pergjigjen per detyrimet e Shoqerise dhe per humbjet e saj tej kuotes se kapitalit te derdhur prej tyre .

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e Shtetit Shqiptar dhe anasjelltas.

## Neni 6

### Pjesemarrja ne fitime

Ortaku merr pjese ne fitimet e Shoqerise perpjestimisht me kuoten e tij dhe mund te kerkoje e te marre informata lidhur me gjendjen tregtare dhe me veprimtarine e Shoqerise ne Keshillin Administrativ .

## Neni 7


### Humbja e cilesise se Ortakut

Cilesia e Ortakut , Shqiptar ose i huaj humbet :

a. Per padenjesi : kemi padenjesi kur vertetohen nga ana e Keshillit Administrativ te Shoqerise veprime konkurrence te pasinqerte ose ka perhapur dokumente ose zbulime apo perhapje nga ana e ortakut te dokumentave ose sekreteve zyrtare qe i perkasin Shoqerise. Kontestimi per kete i behet ortakut nga vete Keshilli Administrativ me leter rekomande me pergjigje ,duke i caktuar nje afat per paraqitjen e justifikimeve te tij brenda pesembedhjete diteve nga marrja e letres . Vendimi i Keshillit Administrativ mund te kundershtohet duke iu drejtuar Kolegjit te Arbitrazhit , sic parashikohet ne nenin 13 te Kontrates .

b. Per falimentimin e ortakut .

Ne rast se vertetohet padenjesia ose falimentimi i ortakut ,shuma baraz me vleften e kuotes se tij kalon ne favor te Shoqerise.



DI VINCENZO ESTERO SRI  
L'AMMINISTRATORE DELEGATO

19

## KREU II

### DETYRIMET E ORTAKEVE

#### Neni 8

#### Derdhja e kuotes

Ortakët duhet të bëjnë derdhjen e kuotes që u takon të Kapitalit themeltar fillestar si dhe ato suplementare , në përputhje me Kontraten , me Statutin , me vendimet e Asamblesë së zakonshme e të jashtëzakonshme dhe të Këshillit administrativ .

#### Neni 9

#### Transferimi i kuotave

Ortakët mund të cedojnë të treta kuotat përkatëse që posedojnë , por një e drejtë e tillë i nënshtrohet së drejtës që gëzojnë ortakët e tjerë për të ushtruar të drejtën e parablerjes . Në këtë rast Ortaku që ka ndermend të cedojë , tërësisht ose pjesërisht kuotën e vet duhet të afrojë me parë ortakëve të tjerë me leter rekomande me përgjigje , ku të tregojë cmimin dhe afatet e pagimit . Ortakët e tjerë , secili në përparim me vlerën e kuotes së vet , kanë të drejtë të blejnë me cmimin e treguar në leter nga ortaku ofrues .

E drejta e parablerjes nga ortakët duhet të ushtrohet detyrimisht brenda tridhjet ditëve nga marrja e ofertes së lartpërmendur , duke ja njoftuar me shkrim me leter rekomande ortakut ofrues.

Kuota (ose pjesë e saj ) për të cilën nuk është ushtruar e drejta e parablerjes , mund t'u cedohet lirish të treta me cmimin e treguar në ofertë (ose edhe me cmim më të lartë). Kur ortaku vendos të cedojë pjesën e vet me një cmim më të ulët ose kur ortaku ofrues nuk ka mundur të cedojë pjesën e vet brenda afatit të mujor duke filluar nga momenti në të cilin e drejta e parablerjes së kuotes (ose pjesës së kuotes) nga ana e ortakëve të tjerë ka kaluar , procedura e ofertes për parablerje duhet të përsëritet nga fillimi.

## KREU III

### KUSHTET EKONOMIKE

#### Neni 10

#### Veprimet e llogarise ( kontabile)

  
**DI VINCENZO ESTERO s.r.l.**  
**L'AMMINISTRATORE DELEGATO**

Veprimet e Shoqerise pasqyrohen ne llogari ( kontabilitet ) duke zbatuar parimet e kontabilitetit sipas legjislacionit shqiptar te cilat pasqyrohen besnikerisht e me perpikmeri ne bilancin vjetor .

## Neni 11

### Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte caktuar 100.000(njeqindmije) USD te ndare ne 1000(njemije) pjese nga 100(njeqind) USD secila.

Kapitali themeltar mund te zmadhohet edhe me kontribute ne natyre .

Ne rastet e zmadhimit te kapitalit themeltar , ortaket rezervojne te drejten e opsjonit perpjestimisht me pjeset qe posedojne . Neqoftese ndonje prej ortakeve nuk do te ushtronte te drejten e opsjonit per nenshkrimin e pjeseve te nje emisjoni te ri , si pasoje e vendimit per zmadhimin e kapitalit , kjo e drejte opsjoni mund te ushtrohet nga ortaket qe e kane ushtruar kete te drejte perpjestimisht me pjeset e poseduara prej tyre.

Menyra dhe afatet e derdhjes se pjeseve te kapitalit themeltar nga ana e ortakeve caktohen nga Keshilli Administrativ duke respektuar Legjislacionin Shqiptar . Shoqeria duhet t'u jape ortakeve nje dokument qe verteton derdhjen e bere .

## Neni 12


### Operacionet financjare.

Shoqeria eshte e autorizuar te gjeje mjete financimi ose kredi, duke ju drejtuar bankave , InSTITUTEVE te kreditit ose te financimit , qofshin ato te vendit ose te huaja , instituteve nderkombetare te financimit ose kreditimit sic mund te quhen .

## Neni 13

### Blerjet e Shoqerise

Shoqeria gezon dhe disponon pasurine e saj ne perputhje me qellimet dhe objektin e vet .



  
DI VINCENZO ESTERO SFRÌ  
L'AMMINISTRATORE DELEGATO

16

Shoqeria mund te bleje dhe administroje pasuri te cdo lloji e natyre , dhe mund t'a jape pasurine e saj si garanci per te marre kredi nga bankat apo institute kreditimi.

Ne Republiken e Shqiperise Shoqeria gezon te drejten te zoteroje pasurine e saj si cdo Shoqeri tjeter apo organizate industriale-tregtare kombtare e Shqiperise sipas ligjeve nr 7496 , dt 04.08.1992 dhe nr 7638 ,dt 19.11.1992 te Kuvendit Popullor te Republikes se Shqiperise me modifikimet dhe plotesimet eventuale .

## Neni 14

### Fondi Rezerve

Shoqeria mund te krijojte nje fond rezerve si dhe fonde te tjera te vecanta per zhvillimin etj. Perberja , shuma e pergjithshme , burimet per krijimin e ketyre fondeve , perdorimi dhe rregullimi i cdo fondi te vecante vendosen nga Keshilli Administrativ ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar.

Shoqeria zoteron mjetet e saj financiare . Detyrimet eventuale qe mund te dalin gjate aktivitetit te saj do te mbulohen nga fondi rezerve dhe nga fondet e tjera, ose nga nenshkrimi prej ortakeve i pjeseve shtese eventuale sipas nenit 8 . Pasurite e Shoqerise pasqyrohen ne bilancin me vlera te shprehura ne leke Shqiptare dhe ne dollare US ne perputhje me rregullat ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Bilanci dhe llogaria e Shoqerise hartohen nga Keshilli Administrativ i Shoqerise ne baze te formave te bilancit dhe llogarive ekonomike te vendosura per shoqerite industriale , tregtare ne Shqiperi.

Bilancet vjetore mbyllen ne 31 dhjetor te cdo viti dhe duhet t'i paraqiten Asamblese se zakonshme brenda 31 marsit te vitit pasardhes.

## Neni 15


### Planet financiare

Aktiviteti i Shoqerise realizohet ne baze te programeve financiare qe bejne pjese ne aktivitetin industrialo-tregetar.

Planet financiare parashikojne kosto dhe fitimet te shprehura ne valute Shqiptare dhe ne dollare US.

Gjendja e prones dhe Llogaria ekonomike jepet ne leke dhe ne dollare US. Rezultatet financiare te aktivitetit te Shoqerise paraqiten ne bilancin vjetor.

Kursi i kembimit te monedhes Shqiptare me monedhe te huaja dhe anasjelltas duhet te jete ai i vendosur nga Banka Kombtare Tregtare Shqiptare.



DI VINCENZO ESTERIO STI  
L'AMMINISTRATORE DELEGATO

K R E U   I V  
A D M I N I S T R I M I

Neni 16

Asambleja

Ortakët mbledhen në Asamble të zakonshme dhe të jashtëzakonshme. Asamblea e zakonshme dhe e jashtëzakonshme kryesohen nga Presidenti i Keshillit Administrativ (ose në rast të pengimit të tij nga Drejtori i Përgjithshëm) i cili emeron një sekretar qoftë dhe jo ortak.

Neni 17

Asamblea e zakonshme

Asamblea e zakonshme e Ortakeve vendos:

- a) për bilancin vjetor
- b) për emërimin e Keshillit Administrativ dhe të Komisionit të Revizionit.
- c) për shpërblimin e anëtarëve të Keshillit Administrativ.

Asamblea e zakonshme e Ortakeve thirret nga Kryetari i Keshillit Administrativ ose nga Drejtori i Përgjithshëm së paku një herë në vit me thirrje me shkrim e cila duhet të dërgohet të paktën 30 ditë përpara me leter rekomande me përgjigje, secilit Ortak që rezultoi i regjistruar në Librin e Ortakeve të paktën 5 ditë përpara ditës së komunikimit të thirrjes.

Kjo thirrje duhet të dërgohet në adresën e dhënë në librin e Ortakeve.

Asamblea e zakonshme e Ortakeve është e vlefshme nga ana konstituive me praninë e Ortakeve që përfaqësojnë së paku gjysmën e kapitalit themeltar. Ajo vendos në mbledhjen e parë dhe të dytë me shumicën absolute të kapitalit themeltar.

Duke marrë parasysh se Shoqëria përbehet nga Ortakë shqiptarë dhe të huaj, dhe se Asamblea e zakonshme mund të thirret në Shqipëri ose jashtë, ajo nuk mund të mbahet aty ku Ortakët e huaj ose shqiptarë nuk kanë mundur të marrin vizën e hyrjes (diplomatike apo të zakonshme) për vendin ku është thirrur Asamblea e zakonshme.

Secili ortak ka të drejtën e një vote për çdo kuotë (pjesë) që posedon dhe mund të delegojë për të marrë pjesë në Asamblenë e zakonshme persona të tretë qoftë edhe jo pjesëtarë të Shoqërisë me përjashtim të Presidentit të Asamblës, të Drejtorit të Përgjithshëm dhe punonjësve të Shoqërisë.

Proces-verbali i Asamblës së zakonshme do hartohet nga sekretari dhe kundershërohet nga Presidenti.

Sidoqoftë është plotësisht e vlefshme edhe pa u thirrur Asamblea e zakonshme e Ortakeve kur në të është e pranishme ose e përfaqësuar i gjithë kapitali themeltar.

  
DI VINCENZO ESTERO  
L'AMMINISTRATORE DELEGATO

18

## Neni 18

### Asamblea e jashtezakonshme

Asamblea e jashtezakonshme e Ortakeve vendos :

- a) per ndryshimin e Kontrates dhe Statutit.
- b) per zmadhimin ose pakesimin e kapitalit themeltar.
- c) per prishjen e shoqerise.

Asambleje e jashtezakonshme duhet te thirret medoemos ne Republiken e Shqiperise , me lajmerim me shkrim te pakten 30 dite para me leter rekomande me pergjigje secilit ortak , qe eshte i regjistruar ne librin e Ortakeve, te pakten 5 dite para marrjes se vendimit per thirrjen . Ky Lajmerim duhet te dergohet ne adresen e treguar ne librin e Ortakeve .

Asamblea e jashtezakonshme e Ortakeve ka vliere konstituive dhe vendos ne thirrjen e pare dhe te dyte me shumice votash prej se paku 5/6 te kapitalit themeltar.

Cdo Ortak ka te drejten e nje vote per cdo pjese qe posedon dhe mund te delegoje per ta perfaqsuar nje person te trete , qofte edhe i huaj per Shoqerine ,me perjashtim te Presidentit te Asamblese , te Drejtorit te Pergjithshem, te zvdrejtorit te Pergjithshem dhe te nenpunesve te Shoqerise.

Proces -verbali i Asamblese se jashtezakonshme do te redaktohet nga sekretari dhe kunderfirmoset nga Presidenti.

## Neni 19

### Proces- verbalet

Ne proces-verbalet si te Asamblese se zakonshme ashtu edhe asaj te jashtezakonshme duhet te permblidhen , qofte dhe me kerkese te nje Ortaku te vetem ,deklaratat e tij .

Vendimet e Asamblese se zakonshme dhe te jashtezakonshme te marra ne perputhje me ligjin shqiptar dhe kete statut jane te detyrueshme per te gjithë Ortaket , edhe per ata qe mungojne apo nuk jane dakort.

## Neni 20


### Lajmerimi per thirje

Asamblea e zakonshme apo e jashtezakonshme e Ortakeve pervec menyres se parashikuar ne nenet 17dhe 18 mund te thiret edhe me faks derguar secilit Ortak , me kusht qe , ne te njejten kohe ( ne te njejten dite ose te nesermen) t'ju dergohet thirja zyrtare me leter rekomande me pergjigje .

Lajmerimi i thirjes , si me faks apo leter rekomande per te mos qene i pavlefshem , duhet te permbaje :

- a) daten dhe oren e thirjes , shprehur me numura dhe germa .

  
DI VINCENZO ESTERO SRI  
L'AMMINISTRATORE DELEGATO  
19



- b) vendin e thirjes shprehur i plote dhe jo me shkurtime .
- c) rendin e dites ku te specifikohen ceshtje te shenuara me numer rendor

Nuk mund te diskutohen ceshtje qe nuk jane vene ne rendin e dites .

## Neni 21

### Keshilli Administrativ

Shoqeria administrohet nga nje Keshill Administrativ i perbere nga shtate anetare . Ata emerohen nga Asambleja e zakonshme dhe mund te mos jene Ortake . Kohezgjatja e detyres se tyre eshte 3 vjecare me perjashtim mte rasteve te rinovimit.

Keshilli Administrativ do te mblidhet sa here Presidenti do ta gjykoje te nevojshme dhe kur kerkohet nga dy administratore ose nga nje administrator dhe nga Drejtori i Pergjithshem i Shoqerise.

Keshilli Administrativ do te emeroje here pas here , nje sekretar qe edhe mund te mos jete anetar .Proces- verbalet e mbledhjes se Keshillit Administrativ qe do te hidhen ne nje liber perkates te vecante dhe do te jene te vlefshem nese jane nenshkruar nga Presidenti dhe sekretari.

Per vlefshmerine e vendimeve te Keshillit Administrativ eshte e nevojshme vota pro e shumices se anetareve te Keshillit Administrativ qe jane ne funksion, me perjashtim te vendimeve per ceshtjet e meposhteme per vlefshmerine e te cilave eshte e nevojshme vota pro e 6/7 te anetareve te keshillit administrativ:

- a) Miratimi i buxhetit vjetor
- b) Miratimi i propozimeve per bilancin e llogarise ekonomike qe do ti paraqitet per aprovim asamblese se ortakeve .
- c) investime qe arrijne per nje vit financiar nje shume me te madhe se 1/10 te kapitalit themeltar.
- d) Shitje e pasurise se Shoqerise.
- e) lidhje e kontratave shume vjecare qe kane te bejne me administrimin dhe qirane e pasurive te Shoqerise.
- f) lidhje kontratash per financim , ose marreveshje financiare me afat te gjate
- g) leshim garancish ose ipotekash te cdo lloji .
- k) pjesemarrje ne shoqeri te tjera ose joint -ventures

Ne se per shkak doreheqjeje , vdekjeje, e njerit ose me shume anetareve te Keshillit Administrativ , vete Keshilli ka fuqi te kooptoje nje anetar zevendsues i cili do qendroje ne kete detyre deri ne Asamblene e ardhshme te ortakeve .

Keshilli Administrativ ka te gjitha kompetencat per administrimin e gjerimin e zakonshem e te jashtezakonshem pa asnje kufizim, me perjashtim te atyre qe parashikohen ne nenet 17,18 lidhur me te drejtat e Asamblese te zakonshme dhe te jashtezakonshme .Cdo anetar i Keshillit Administrativ gëzon te drejten e nje vote te vetme .

  
DI VINCENZO ESTERO  
L'AMMINISTRATORE DELEGATO

## Neni 22

### Presidenti i Keshillit Administrativ

Presidenti i Keshillit Administrativ qe emerohet nga vete Keshilli Administrativ eshte perfaqesuesi ligjor i Shoqerise dhe ka te drejten e firmes per shoqerine .

Presidenti i Keshillit Administrativ zgjidhet per nje periudhe 3-vjecare te rinovueshme dhe ka keto detyra :

- te perfaqesoje shoqerine ne mardheniet me te tretet
- te organizoje veprimtarine e Keshillit Administrativ .

## Neni 23

### Drejtori i pergjithshem

Veprimtaria operative e Shoqerise drejtohet nga Drejtori i Pergjithshem i cili emerohet nga Keshilli Administrativ , qe perben organin ekzekutiv te Shoqerise.

Drejtori i Pergjithshem ka keto kompetenca :


- a) te vere ne zbatim vendimet e Asamblese dhe Keshillit Administrativ .
- b) te organizoje dhe te racionalizojte punen per permbushjen e objektit te shoqerise, duke relatuar me Keshillin administrativ .
- c) te administroje pasurine dhe mjetet e Shoqerise , perfshire mjetet financiare , brenda caqeve te vendimeve te Keshillit Administrativ .
- d) te drejtoje dhe te kontrolloje veprimtarine e filjaleve dhe agjensive te shoqerise.
- e) te perfaqesoje shoqerine me prokure te posacme te Keshillit Administrativ para autoriteteve gjyqsore dhe arbitrale dhe ne mardhenie me te tretet si edhe para organizmave dhe autoriteteve shqiptare dhe te huaja .
- f) te lidhe kontrata te cfaredo lloji e natyre ne emer dhe per llogari te Shoqerise.
- g) te beje cdo pagese qe detyrohet Shoqeria , te marre dhe pushoje nga puna personelin e Shoqerise, me perjashtim te drejtuesve, dhe te nenshkruaje kontratat perkatese .

Drejtori i Pergjithshem eshte pergjegjes ndaj Shoqerise per detyrimet qe jane brenda kompetences se tij ekskluzive .

Drejtori i Pergjithshem qendron ne funksion per nje periudhe 3 vjecare me mundesi riemerimi .

## Neni 24

### Zv /drejtori i Pergjithshem



  
DI VINCENZO ESTERO  
L'AMMINISTRATORE DELEGATO

21



Zv/ drejtori i pergjithshem emerohet nga Keshilli Administrativ per nje periudhe 3 vjecare dhe zevendeson Drejtorin e pergjithshem kur pengohet ky i fundit .

Zv/drejtori i Pergjithshem mund te beje gjithashtu pagesa qe detyrohet Shoqeria deri ne nje shume maksimale qe do te percaktohet nga Keshilli Administrativ .

Neni 25

#### Komisjoni i Revizjonit ( kolegji sindakal)

Per kontrollin e veprimtarise te Shoqerise dhe te filjaleve te saj krijohet nje komisjon revizjoni ( kolegji Sindikal ).

Presidenti dhe anetaret e Komisionit te Revizjonit emerohen nga Asamblea e Ortakeve .

Komisjoni i Revizjonit perbehet nga pese anetare te emeruar per 3 (tre vjet). Presidenti dhe anetaret e Komisionit te Revizjonit nuk duhet te jene nepunes te Shoqerise apo Filjaleve te saj .

Neni 26

#### Marrdheniet e punes

Marrdheniet e punes ndermjet Shoqerise , filjaleve e agjensive te saj dhe punonjesve te tyre rregullohen me kontraten e punes . Per ceshtjet qe nuk jane percaktuar ne kontraten e punes zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fuqi ne kete fushe , ose te legjislacionit te vendit te filjalit te huaj ku punonjesi kryen veprimtarine e vet ne menyre stabel.

#### K R E U V

#### MBARIMI I VEPRIMTARISE

Neni 27

Prishja e Shoqerise

Shoqeria priset :

- a) kur mbaron afati i caktuar i kohezgjatjes se saj .
- b) kur s'ka mundesi te realizohet objekti i Shoqerise
- c) me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme

  
DI VINCENZO ESTERO SH  
L'AMMINISTRATORE DELEGATO



22

Neni 26

Likuidimi

Likuidimi i Shoqerise behet sipas normave te legjislacionit shqiptar ne fuqi ne castin e likuidimit.

Asamblea e zakonshme percakton menytrat e likuidimit dhe emeron nje ose me shume likuidatore qofshin dhe jo ortake, duke percaktuar kompetencat dhe shperblimet.

Ne rast prishjeje te shoqerise mbetja eventuale , pasi paguhen te gjitha detyrimet u ndahet ortakeve ne proporcion me pjeset ( pro-quota ).

Neni 29

Mbarimi i Filjaleve

Mbarimi i veprimtarise se Filjalit vendoset nga Keshilli Administrativ.

Likuidimi i Filjaleve te huaja rregullohet nga legjislacioni i shtetit ne te cilin eshte vendosur Filjali.

Neni 30

Mosmarreveshjet dhe ligji i zbatueshem.

Persa i perket mosmarreveshjeve qe mund te lindin ndermjet ortakeve ose midis Shoqerise dhe ortakeve gjate veprimtarise se Shoqerise dhe persa i perket ligjit te zbatueshem , do te zbatohen nenet 13 dhe 14 te kontrates

Neni 31

Gjuha

Ky statut qe perbehet nga 31 nene hartohet ne gjuhet shqipe dhe italiane duke patur te dy tekstet fuqi te barabarte lidhur me zbatimin dhe interpretimin e tij per te gjitha ortaket, shqiptare dhe te huaj.

Hartuar , lexuar dhe nenshkuar ne Tirane me 6 maj 1993.

Per ALBTURIST

Per D.V.E

Valentin Prifti



Antonio Napoleone



DI VINCENZO ESTERO 811  
L'AMMINISTRATORE DELEGATO

23

**V E N D I M**

**Mbi rregjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " DV- ALBTURIST HOTELIERS SHPK "**

Ne Tirane , sot me date 13.07.1993 , Une , Marjana Dedi , gjygtare ne Gjykatën e Rrethit Tirane , mora ne shqyrtim kerkesen dhe dokumentat e paraqitura ( kontraten , statutin dhe Autorizimin nr 62 date 8.07.1993 te Ministrise Tregetise dhe Bashkepunimit Ekonomik me Jashte ), nga ndermarrja Albturist Tirane , per rregjistrimin si person juridik te shoqerise " DV- ALBTURIST HOTELIERS SHPK" me emertimin e shkurtuar " DV- ALBA SHPK " me statusin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe duke respektuar kerkesat formale juridike ne baze te ligjit nr 7638 date 19.11.1992

**K O N S T A T O V A :**

Kerkesa dhe dokumentat e kerkuesit per rregjistrimin e shoqerise " DV- ALBTURIST HOTELIERS SHPK " ( DV- ALBA SHPK) ehste e drejte dhe ne baze te ligjit duhet pranuar.

**P E R K E T O A R E S Y E**

Ne baze te ligjit nr 7512 date 10.08.1991 " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private , te nismes se lire, te veprimtarive private te pavarura dhe privatizimit " dhe te ligjit nr 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare " ,

**V E N D O S A**

Rregjistrimin e Shoqerise tregtare " DV- ALBTURIST HOTELIERS SHPK " me emertimin e shkurtuar " DV- ALBA SHPK " si person juridik i te drejtes Shqiptare . Shoqeria " DV- ALBTURIST HOTELIERS SHPK " e ka seline e saj ne hotel " Tirana" , sheshi Skenderbej Tirane dhe ka statusin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar . Themeluesit e saj jane Albturist , Bulevardi " Deshmoret e kombit " , nr 8 Tirane / Shqiperi dhe DI VINCENZO ESTERO Srl , via Enrico Monaci , nr 21 Roma / Itali. Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete ristrukturimi i Hotel " Tirana" ne Tirane , ushtrimi ne Shqiperi i industrise se turizmit , ristrukturimi dhe administrimi i komplekseve

turistike . Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100.000 dollare USD i ndare ne 1000pjese nga 100 dollare USD secila .Kapitali themeltar do te zmadhohet nga ortakët me kontribute ne natyre dhe ne para .

Hollesite lidhur me organizimin , drejtimin , funksionimin e shoqerise tregtare " DV-ALBTURIST HOTELIERS SHPK " percaktohen ne statutin e shoqerise qe eshte bashkelidhur.

Kunder ketij Vendimi mund te behet ankim ne shkallen e dyte.

**G J Y Q T A R I**

Tirane me 13,07,1993

**Marjana Dedi**

